

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -

Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti i Buxhetit - Budget Department - Budzet Department

DATE	24.07.2023
REFERENCË	UV. - 152 / 2023
PËR/ZA/TO:	znj. Feride Podvorica, zv. Drejtore e Departamentit Ligjor, Ministria e Drejtësisë
CC:	znj. Anita Kalanderi, Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
NGA/OD/FROM:	Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinionimi i Departamentit të Buxhetit për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor të Projekt ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

E nderuara znj. Podvorica,

Bazuar në kërkesën për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor të Projekt ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, obligimit sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023

Departamenti i Buxhetit të Kosovës, paraqet me sa vijon:

I. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PROJEKT LIGJIT

Ky projekt ligj rregullon shërbimet sociale dhe familjare, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve publike dhe private që hartojnë politika dhe ofrojnë shërbime sociale dhe familjare. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për institucionet publike dhe private, organizatave joqeveritare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve sociale për të siguruar mirëqenien, kujdesin, dinjitetin dhe jetën e personave në nevojë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

II. OPINIONI PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT BUXHETOR (VNB) NGA ORGANI PROPOZUES

Ministria e Drejtësisë (MD), si organ propozues ka përgatitur vlerësimin e ndikimit buxhetor të këtij projektligji dhe e ka paraqitur përmes formularit të vlerësimit të ndikimit buxhetor, sipas të cilit vlerësohet që ky projektligj do të ketë kosto shtesë buxhetore në shumë prej 14,038.570 euro për vitet 2024-2025, si dhe shtim të stafit për 215 pozita të reja dhe atë 100 pozita të reja për vitin 2024 dhe 115 pozita të reja shtesë për vitin 2025.

KOSTOJA TOTALE (niveli qendror dhe komunal) e paraqitur nga propozuesi i këtij projekt ligji është në shumë prej 65,629,203 euro.

Vitet	2023	2024	2025	Totali
Pagat dhe Shtesat	3,041,440	3,840,556	4,815,045	11,697,040
Mallrat dhe shërbimet	1,652,445	2,289,302	2,460,047	6,401,795
Shpenzimet Komunale	145,700	148,150	176,150	470,000
Subvencionet dhe Transferet	3,778,000	6,943,500	7,003,500	17,725,000
Shpenzimet Kapitale	6,290,368	11,290,000	11,755,000	29,335,368
Totali	14,907,953	24,511,508	26,209,742	65,629,203

NIVELI QENDROR

Vitet	2023	2024	2025	Totali
Pagat dhe Shtesat	173,436	174,303	175,175	522,914
Mallrat dhe shërbimet	77,335	77,335	77,335	232,005
Shpenzimet Komunale	8,000	8,000	8,000	24,000
Subvencionet dhe Transferet	2,600,000	2,600,000	2,600,000	7,800,000
Shpenzimet Kapitale	0	0	0	0
Totali	2,858,771	2,859,638	2,860,510	8,578,919

NIVELI KOMUNAL

Vitet	2023	2024	2025	Totali
Pagat dhe Shtesat	2,868,004	3,666,253	4,639,870	11,174,126
Mallrat dhe shërbimet	1,575,110	2,211,967	2,382,712	6,169,790
Shpenzimet Komunale	137,700	140,150	168,150	446,000
Subvencionet dhe Transferet	1,178,000	4,343,500	4,403,500	9,925,000
Shpenzimet Kapitale	6,290,368	11,290,000	11,755,000	29,335,368
Totali	12,049,182	21,651,870	23,349,233	57,050,284

Ndarjet aktuale buxhetore janë në shumë prej 51,598,433 euro për vitet 2023-2025 të parapara për zbatimin e këtij projekt ligji e që janë të planifikuara në Ligjin Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024-2025 janë për këto nën-programe:

Në kuadër të Kuvendeve Komunale:

1. Qendrat për punë sociale
2. Shërbimet rezidenciale (shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve, shtëpitë për personat me aftësi të kufizuar, shtëpitë për persona të moshuar)

Në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë

1. Shpenzimet bazike per strehimore,
2. Këshilli i Përgjithshme Shërbime Sociale dhe Familjare,
3. Departamenti për shërbime sociale dhe familjare

Vitet	2023	2024	2025	Totali
Pagat dhe Shtesat	3,041,440	3,060,556	3,081,045	9,183,040
Mallrat dhe shërbimet	1,652,445	1,639,302	1,660,047	4,951,795
Shpenzimet Komunale	145,700	148,150	156,150	450,000
Subvencionet dhe Transferet	3,778,000	3,943,500	4,003,500	11,725,000
Shpenzimet Kapitale	6,290,368	9,156,615	9,841,615	25,288,598
Totali	14,907,953	17,948,123	18,742,357	51,598,433

NIVELI QENDROR

Vitet	2023	2024	2025	Totali
Pagat dhe Shtesat	173,436	174,303	175,175	522,914
Mallrat dhe shërbimet	77,335	77,335	77,335	232,005
Shpenzimet Komunale	8,000	8,000	8,000	24,000
Subvencionet dhe Transferet	2,600,000	2,600,000	2,600,000	7,800,000
Shpenzimet Kapitale	0	0	0	0
Totali	2,858,771	2,859,638	2,860,510	8,578,919

NIVELI KOMUNAL

Vitet	2023	2024	2025	Totali
Pagat dhe Shtesat	2,868,004	2,886,253	2,905,870	8,660,126
Mallrat dhe shërbimet	1,575,110	1,561,967	1,582,712	4,719,790
Shpenzimet Komunale	137,700	140,150	148,150	426,000
Subvencionet dhe Transferet	1,178,000	1,343,500	1,403,500	3,925,000
Shpenzimet Kapitale	6,290,368	9,156,615	9,841,615	25,288,598
Totali	12,049,182	15,088,485	15,881,848	43,019,514

Siç shihet nga tabelat e mësipërme ky projeksion ka kosto shtesë buxhetore në shumë prej 14,030,770 euro për vitet 2024-2025, e cila kosto është e shpërndarë sipas kategorive të shpenzimeve dhe viteve, si vijon:

Vitet	2023	2024	2025	Totali
Pagat dhe Shtesat	0	780,000	1,734,000	2,514,000
Mallrat dhe shërbimet	0	650,000	800,000	1,450,000
Shpenzimet Komunale	0	0	20,000	20,000
Subvencionet dhe Transferet	0	3,000,000	3,000,000	6,000,000
Shpenzimet Kapitale	0	2,133,385	1,913,385	4,046,770
Totali	0	6,563,385	7,467,385	14,030,770

Kostoja shtesë në shumë prej 14,030,770 euro paraqet ndryshimin në mes të kostos totale të paraqitur nga propozuesi e që është 65,629,203 euro dhe shumës prej 51,598,433 euro që janë ndarjet aktuale buxhetore të parapara me Ligjin Nr.08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 dhe vlerësimet 2024-2025.

Kjo kosto shtesë është paraqitur për mbulimin e këtyre aktiviteteve.

- Zhvillimi i sistemit për strehim familjar për të rriturit, neni 74 paragrafi 4.5, kostoja shtesë për vitin 2024 është në shumë prej 1,000,000 euro dhe për vitin 2025 është në shumë prej 1,000,000 euro.
- Financimi shtesë për Qendrat për punë sociale, neni 74 paragrafi 4.1, kostoja shtesë për vitin 2024 është në shumë prej 3,333,385 euro ndërsa për vitin 2025 kostoja shtesë është në shumë prej 3,421,185 euro.
- Qendrat e pranimit, neni 74 paragrafi 3.9, kostoja shtesë për vitin 2024 është në shumë prej 300,000 euro ndërsa për vitin 2025 është në shumë prej 246,000 euro.
- Ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare nga Organizatave Joqeveritare të licencuara, neni 15 paragrafi 3, për vitin 2024 kostoja shtesë është në shumë prej 1,000,000 euro, ndërsa për vitin 2025 është në shumë prej 1,000,000 euro.
- Punonjës social, jurist, psikolog, sociolog dhe pedagog që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare në Qendrat për punë sociale, nen 65 paragrafi 3, për vitin 2024 kostoja shtesë është në shumë prej 930,000 euro si dhe shtim të numrit të pozitave për 100 punonjës të profileve të lartcekura dhe për vitin 2025 kostoja shtesë është në shumë prej 1,808,000 euro si dhe shtim të numrit të pozitave edhe për 115 punonjës të profileve të lartcekura. Gjithsejtë janë 215 pozita të reja për profilet e lartcekura për vitet 2024-2025.

PËRFUNDIM

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit vlerëson se Projekt ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare do të ketë kosto shtesë buxhetore në shumë prej 14,030,770 euro për vitet 2024-2025 si dhe shtim të numrit të punëtorëve për 215 pozita të reja, mjete dhe pozita të cilat nuk janë të parapara me Ligjin Nr.08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për Buxheti e Republikës së Kosovës për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024-2025 për institucionet që janë përgjegjëse për zbatimin e këtij projektligji siç janë Qendrat për punë sociale që funksionojnë në kuadër të Komunave të Kosovës.

Në këtë projektligj me nenin 74 paragrafi 5 është i paraparë që financimi komunal për shërbime sociale dhe familjare, do të rregullohet me formulën e financimit të përcaktuar nga Ministria përkatëse për Financa në garantin e veçantë për shërbime sociale dhe familjare në pajtim me Ligjin përkatës për financat e pushtetit lokal. Ligji aktual që është në fuqi për financa të pushtetit lokal nuk ka të paraparë financim me grant të posaçëm për shërbime sociale dhe familjare për nivelin komunal.

Ndryshe, të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara ta zbatojnë paragrafin 4, 5 dhe 7 të nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 ku thuhet:


4. Çdo nismë e re për shpenzime, përfshirë këtu legjislacionin e ri të propozuar, që nuk ka ndarje buxhetore të përfshirë në tabelat e bashkangjitura, nuk do të marrë ndarje buxhetore përveç nëse zbatohen shkurtime përkatëse në ndarjet e tjera buxhetore në vlerë të njëjtë.

5. Asnjë projektligj nuk mund të procedohet në Qeveri apo në Kuvend për aprovim nëse nuk ka të identifikuar burimin e financimit për vitin fiskal 2023 dhe vitet pasuese të parapara në projeksionet afatmesme të shpenzimeve buxhetore 2024-2025 të paraparë me nenin 5, paragrafi 1., dhe tabelat në kuadër të këtij ligji.

7. Nëse Qeveria aprovon një nismë të re që prodhon obligime buxhetore për një apo më shumë organizata buxhetore pas vitit fiskal 2023, atëherë ky obligim buxhetor me automatizëm trajtohet në përcaktimin e ndarjeve për këto Organizata Buxhetore në procesin e përgatitjes së buxhetit për vitin vijues.

Përgatitur nga:

Gëzim Bislimi, Analist i lartë i buxhetit



Konfirmoi:

Milaim Aliu, Udhëheqës i divizionit të buxhetit qendror

